VENDIM
Nr. 57, datë 25.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 15.6.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 28 Akti, që i përket:

KËRKUES: Tahir Kurti

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë

Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 5041, datë 13.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1136, datë 11.5.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2015-299, datë 12.2.2015, të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, Tahir Kurti, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka qenë efektiv në repartin ushtarak nr. 9910, Berat, deri në datën 28.3.1994. Me urdhrin nr. 751, datë 28.3.1994, kërkuesi ka dalë në rezervë. Sipas vërtetimit, për efekt të përfitimeve nga sigurimet suplementare, të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, paga referuese e kërkuesit në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës nga Forcat e Armatosura (FA) ka qenë 13.454 lekë. Kërkuesi ka pasur vjetërsi pune në FA për një periudhë prej 21 vjetësh e 8 muajsh. Nga përmbajtja e vendimit nr. 98, datë 13.6.2000, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë rezulton se kërkuesi, nga data 6.4.1999, është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 8.610 lekë/muaj, llogaritur në bazë të pagës referuese dhe ligjit nr. 8087, datë 13. 3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura" (ligji nr. 8087/1996), të ndryshuar. Pas rritjeve të pësuara ndër vite, sipas VKM-ve përkatëse, masa e pensionit të kërkuesit, nga data 1.5.2009, ka qenë në masën 16.562 lekë.

2. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës, duke pretenduar se DRSSH-ja Tiranë, në përcaktimin e pensionit për vjetërsi shërbimi, nuk ka përmbushur detyrimet e caktuara nga nenet 11, germat "a" dhe "b" të ligjit nr. 8087/1996 dhe as ka bërë indeksimin e masës së pensionit, sipas VKM-ve përkatëse në vite.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5041, datë 13.6.2011, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1136, datë 11.5.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5041, datë 13.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-299, datë 12.2.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

II

6. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ai ka parashtruar se:

6.1. Vendimet gjyqësore, objekt shqyrtimi, kanë cenuar nenin 42 të Kushtetutës për shkak të moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor. Gjykimi në Gjykatën e Lartë është realizuar për 2 vjet e 9 muaj nga shpallja e vendimit të gjykatës së apelit, pra jashtë afatit 90-ditor të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (ligji nr. 49/2012), të ndryshuar.

6.2. Është cenuar e drejta për përfitimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, pasi zgjidhja e mosmarrëveshjes nuk është kryer në përputhje me ligjin në fuqi në çastin e lindjes së të drejtës. Gjykatat me vendimet e tyre i kanë cenuar kërkuesit të drejtën e ndihmës të parashikuar në nenin 52 të Kushtetutës dhe nuk kanë respektuar nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, si dhe hierarkinë e burimeve të së drejtës.

6.3. Gjykatat kanë cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e fituar për pension të parakohshëm, duke zvogëluar masën e pensionit në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese për ligjin "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve". Gjithashtu, gjykatat nuk kanë marrë parasysh vendime të ngjashme gjyqësore për trajtimin e ushtarakëve me pension të parakohshëm, të cilat përbëjnë gjë të gjykuar.

6.4. Është cenuar e drejta e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, e garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kërkuesi, ndryshe nga kolegët e tjerë të tij, nuk ka përfituar nga indeksimi i pensionit dhe Gjykata e Lartë në rastin e tij nuk ka respektuar nenet 11 dhe 18 të ligjit nr. 8087/1996 për llogaritjen e masës së pensionit.

7. ***Subjekti i interesuar,*** Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ka prapësuar si vijon:

7.1. DRSSH-ja Berat, së cilës i është drejtuar kërkuesi për përfitimin e pensionit të parakohshëm, e ka llogaritur masën e pensionit konform ligjit nr. 8087/1996, si dhe indeksimeve të përcaktuara në VKM-të përkatëse. Pretendimi i kërkuesit se në llogaritjen e masës së pensionit që i takon nuk është zbatuar ligji në fuqi në çastin e lindjes së të drejtës, nuk qëndron.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

8. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

9. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, në jurisprudencën e saj konstante Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion

kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit apo interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 4, datë 5.2.2014; nr. 1, datë 20.1.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Kërkuesi ka pretenduar keqzbatimin e ligjit material nga gjykatat e zakonshme. Sipas tij, zgjidhja e mosmarrëveshjes nuk është kryer në përputhje me ligjin në fuqi në çastin e lindjes së të drejtës. Gjykatat me vendimet e tyre i kanë cenuar kërkuesit të drejtën e ndihmës të parashikuar në nenin 52 të Kushtetutës, nuk kanë respektuar nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe hierarkinë e burimeve të së drejtës. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë marrë parasysh vendime të ngjashme gjyqësore për trajtimin me pension të parakohshëm që përbëjnë gjë të gjykuar. Gjykata vlerëson se këto pretendime të kërkuesit kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme dhe si të tilla nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata.

11. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se është cenuar e drejta e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, e garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi ai nuk ka përfituar nga indeksimi i pensionit sipas VKM-ve përkatëse dhe as nga shtesa prej 2% për çdo vit vjetërsi mbi 15 vjet. Gjykata e Lartë, sipas tij, nuk ka respektuar nenet 11 dhe 18 të ligjit nr. 8087/1996 për llogaritjen e masës së pensionit dhe nuk ka marrë parasysh raste analoge për përfitues të tjerë ushtarakë, të cilëve u është njohur rritje e pensionit. Edhe këto pretendime të kërkuesit, në vlerësimin e Gjykatës, kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit material nga ana e gjykatave të zakonshme, çka nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Për rrjedhojë, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata.

12. Sipas kërkuesit, gjykatat kanë cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e fituar për pension të parakohshëm, duke zvogëluar masën e pensionit në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese për ligjin "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve". Gjykata ka theksuar se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtrojnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Është detyrë e palëve të shpjegojnë arsyet të cilat kanë çuar, sipas këndvështrimit të tyre, në shkelje të Kushtetutës, dhe më konkretisht të procesit të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 42, datë 25.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë kuptim, kërkuesi nuk ka arritur të sjellë argumente të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin e mësipërm për cenimin e parimit të sigurisë juridike, duke mos arritur ta ngrejë atë në nivel kushtetues. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me këtë pretendim.

13. Në lidhje me pretendimin për mosgjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se, në bazë të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individi legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 14, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm

14. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore, objekt shqyrtimi, kanë cenuar nenin 42 të Kushtetutës për shkak të moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor. Gjykimi në Gjykatën e Lartë është realizuar për 2 vjet e 9 muaj nga shpallja e vendimit të Gjykatës së Apelit, pra jashtë afatit 90-ditor të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012, të ndryshuar. Sipas kërkuesit, çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 29.4.2010 dhe ka përfunduar pas 4 vjetësh e 9 muajsh.

15. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij

kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjithashtu, Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeja e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeja e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (shih *vendimin nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të arritur në përfundimin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se duhet të merret në analizë secili prej elementeve të sipërcituara.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

17. Lidhur me periudhën e *kohës që duhet marrë në konsideratë,* nga materialet bashkëlidhur kërkesës dhe të dhënat në faqen zyrtare *web* të Gjykatës së Lartë rezulton se çështja në shqyrtim është regjistruar në atë gjykatë në datën 2.8.2012 dhe vendimi është marrë në datën 12.2.2015, pra pas 2 vjetësh e 6 muajsh nga regjistrimi. Për rrjedhojë, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë rezulton të ketë zgjatur për një periudhë rreth 2 vjet e 6 muaj.

ii. Kompleksiteti i çështjes

18. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme *(shih vendimin nr. 59, datë 16.9.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012, i ndryshuar. Çështja në shqyrtim ka për objekt detyrimin e një organi (DRSSH, Tiranë) për të ndryshuar vendimin e tij për përcaktimin e masës së pensionit të kërkuesit, për rrjedhojë ajo nuk paraqet kompleksitet që mund të justifikonte vonesa në shqyrtimin e saj nga Kolegji Administrativ, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkuesit

20. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata çmon se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv. Sjellja e autoriteteve

21. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së, i cili thotë: "*Gjykata kujdeset për zhvillimin*

e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme", dhe në nenin 171/a të KPC-së, që thotë: "*Gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj"* (*shih vendimin nr. 45, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka konstatuar se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 ndër parimet e gjykimit administrativ ka përcaktuar garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Përderisa ligjvënësi ka përcaktuar këto afate kohore (90 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t'u zbatuar nga gjykatat administrative. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 59, datë 16.9.2016; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se justifikimi në çështje të ngjashme se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk është i bazuar. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt, është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 59, datë 16.9.2016; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit të interesuar se shtyrja në kohë e shqyrtimit të çështjes është bërë për shkak të ngarkesës së çështjeve, është i pabazuar.

24. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm, është i drejtë dhe duhet pranuar. Megjithëse zvarritja e procesit nuk përbën shkak për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, sipas objektit të kërkesës, fuqia detyruese e vendimit të Gjykatës shërben për parandalimin e zvarritjeve të proceseve gjyqësore nga ana e gjykatave. Gjykata nënvizon se nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë dhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare (*shih vendimin nr. 15, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm.
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos

Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha